



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:019128  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05558790

A.nr.234/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti Bioteknik, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, kundër të paditurit Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, me palën e interesit J.. D., të përfaqësuar nga A.. I. të cilët i përfaqëson Sh..Th.. avokat nga P., për shkak të anulimit të vendimit Nr.03/1638/210 i datës 11.12.2020, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. SHFUQIZOHET Aktgjykimi i kësaj Gjykate A.nr.234/2021, i datës 20.10.2023, dhe LEJOHET rishikimi i Vendimit sipas kërkesës së palës së interesuar J.. D., të përfaqësuar nga A.. I. e të cilët i përfaqëson Sh.. Th., avokat nga Prishtina

II. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti Bioteknik, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore.

III. ANULOHET Aktvendimi Nr.03/1638/210 i datës 11.12.2020 i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura

IV. HUDHET POSHTË kërkesa e palës së interesit J.. D. me të cilën ka kërkuar nga Gjykata ti kthehet e drejta pronësore ndërhyrësit, si e palejuar.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse dhe palës së interesit e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 02.02.2021 e pastaj me plotësimin e padisë të datës 10.02.2021, ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi, vendim ky i nxjerrë nga e paditura. Me padi, paditësja pohon se në përgjigjen e dhënë të paditurës se Aktgjykimi C.nr.1150/96 i datës 15.09.1996, nuk mund të ekzekutohet pasi që i njëjti është anti kushtetues, se kërkuesi J.. D.., nëse analizohet i njëjti aktgjykim, ka të meta në përpilimin e të njëjtit si dhe kjo çështje është përfunduar dhe vendosur në procedura gjyqësore pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, është dhënë sqaruar se kërkuesi disa herë ka dorëzuar padi në gjykatë dhe se në këtë çështje gjyqësore kemi të bëjmë me çështje të gjykuar res judicata.

Shton se me datë 10.11.2011, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me aktvendimin ASC-11-0046 e refuzon si të pabazuar ankesën e paditësve J.. T.. D.., 2. M.. T.. D.. dhe 3. S.. T.. S.., për vërtetimin e pronësisë në njësinë kadastrale 1550-1 në vendin e quajtur A..H.. ZK Prishtinë në sipërfaqe prej 1.04.05 ha kundër të paditurave NSH Instituti për Hulumtime Shkencore dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërkaq me datë 11.06.2012, po e njëjta dhomë, me Aktvendim e hedh poshtë padinë si të papranueshme, ndërkaq Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 03.06.2020 me Aktvendimin C.nr.2267/20 e konsideron të tërhequr padinë e paditësve D.. J.., D.. M.. dhe S.. S.., pasi që përfaqësuesi i tyre kishte tërhequr padinë.

Paditësja po ashtu pohon se sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përkatësisht neni 361 është paraparë si në vijim: *“Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente 1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*. Paditësja po ashtu i referohet edhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013 për zbatimin e Ligjit për Kadastër. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin aprovohet si e bazuar padia dhe anulohet vendimi i kundërshtuar me padi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditëses deklaroi: *“Pasi që çështja është e ndjeshme unë deklaramin për seancë e kam bërë eshë me shkrim, andaj deklaroj se ne qëndrojmë pranë padisë dt. 02.02.2021, të cilën kemi kërkuar nga gjykata ku edhe tani kërkojmë anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi , vendim i nxjerr nga ana e të paditurës. Paditësja pohon se në përgjigje në padi të të paditurës sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr.1150/96 dt. 15.09.1996, nuk mund të ekzekutohet për shkak se i njëjti aktvendim është antiligjor , anit kushtetues sepse ky Aktgjykim kur të realizohet ka të meta thelbësore dhe kjo çështje është përfunduar dhe vendosur në procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, andaj J.. D.. R.. M.., D.. M.., J..*

*J., D.D. M. A., J. D., S. S... dhe M. D..., të gjithë nga Komuna e Fushë Kosovës, tani e tutje do ti përdori vetëm si J. D. etj. J. D. etj. Disa herë kanë dorëzuar padi në gjykatë por çështja gjyqësore për këtë çështje është zgjedhur dhe përfunduar andaj këtu kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar Res Judicata, provë Dhoma e Posaçme me aktvendimin e saj ASC-11-0046 dt.10.11.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditëse J. D. etj., e cila ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë në njësinë kadastrale 1559-1 Z.K. Prishtinë, në vendin e quajtur A.. dhe e njëjta gjykatë e hedh poshtë padinë si të pa pranueshme, provë tjetër Gjykata Themelore në Prishtinë me dt. 03.06.2020, me aktvendimi e saj C.nr.2267/20 e konsideron të tërhequr padinë paditëse dhe të tjerëve sepse me dt.28.12.2007, në Gjykatën Komunale në Prishtinë është dorëzuar padi për anulim të vendimit për marrjen e pronës . Provë tjetër Gjykata Komunale në Prishtinë C.nr. 1292/10 dt. 20.06.2010, ka marr aktvendim me të cilën shpallet in kompetent , për të sqaruar çështjen e paditësve . Në cilësi të provës materiale gjykatës ia dorëzoi Udhëzimin Administrativ Nr. 2003/3 për rolin dhe mandatin e Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë i cili institut nga viti 2002 e tutje është institucion publik në kuadër të MBPZHR-së. Gjykatës i dorëzoi certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-01559-1 të dt.06.03.2024”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbesim në tërësi pranë padisë së ushtruar dhe deklarimit të sotëm pran kësaj gjykate duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të të gjitha provave, fakteve dhe rrethanave me rëndësi lidhur me këtë çështje juridike Kontestimore për vërtetim të pronësisë të merr aktgjykim të drejtë real dhe objektiv pra të refuzohet kërkesa e palës paditëse si e pa bazuar”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 17.05.2022 e ka mohuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar ndër të tjera se Avokatura Shtetërore dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk kanë provuar në këtë procedurë administrative se ekziston ndonjë akt juridik i plotfuqishëm i cili anulon aktgjykimin, zbatimin e së cilës e kërkon pala ankuese apo ndonjë akt juridik i cili përcakton shtyrjen e zbatimit të tij, prandaj pohon se e njëjta nuk mund të vendos mbi ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme pasi që si organe ekzekutive në mirëmbajtjen e regjistrit pronësor janë të obligueshme ti zbatoj si të tilla.. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon padinë si të pabazuar dhe e vërteton aktvendimin e AKK-së.

Pala e interesit J.. D., me përgjigjen në padi të datës 29.03.2024 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar duke pohuar se përmes Aktgjykimit P.br.1150/96 të datës 16.08.1996 ndërhyrësi e ka fituar të drejtën pronësore në mënyrë të ligjshme dhe me punë të vlefshme juridike, duke i propozuar gjykatës kthimin e të drejtës pronësore tek ndërhyrësi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i palës së interesit deklaroi: *“E kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditëse si të pa bazuar dhe anti ligjore për faktin sepse ky proces Kontestimore veç se është çështje e gjykuar siç potencoi paditësja , por është çështje e gjykata me aktgjykimin e viti 1996 i cili aktgjykim gjendet në shkresat e lëndës dhe se është anti kushtetuese të zhvillohet një proces tjetër lidhur me një Aktgjykim të plotfuqishëm i cili me asnjë akt tjetër nuk është kundërshtuar. Pretendimet e palës paditëse se janë zhvilluar disa aktgjykime lidhur me këtë kontest është dashur të lëshohet me përmbajtjen se çka është vendos e këto*

*vendime –aktgjyqime. Po fillojmë me aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të shkallës së parë ku si provë e këtij aktvendimi thuhet se ky aktvendim hedhet poshtë nga Dhoma e Posaçme për faktin se Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi padinë, pastaj e kemi edhe aktvendimin e shkallës së dytë i cili e jep të njëjtin verdikt si shkalla e parë, pala si rezultat i këtyre aktvendimeve i drejtohet Gjykatës së rregullt në procedurë Kontestimore për shqyrtimin e kësaj çështje dhe ende pa u vendosur lidhur me këtë pala e interesit e gjen Aktgjykimin e Gjykatës Komunale P.br.1150/96 dt. 16.08.1996, aktgjykim ky i plotfuqishëm me dt. 16.08.1996, dhe e tërheq padinë nga Gjykata Komunale Prishtinë, andaj pretendimet e palë së paditur janë pretendime të cilat e cenojnë rendin juridik të Republikës së Kosovës, i cenojnë konventat ndërkombëtare të BE-së, nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës, andaj Aktgjykimi i cili ka vendosur lidhur me këtë çështje Kontestimore është i plotfuqishëm, përmbushëm, ekzekutueshëm dhe si i tillë moszbatimi i këtij vendimi konsumon elementet e veprës penale. Kërkojmë nga gjykata të shfuqizohet aktvendimi A.nr.234/21 i dt.20.11.2023, ti kthehet e drejta pronësore ndërhyrësit të cilën të drejtë ia garanton rendi kushtetues”.*

*Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: “E kundërshtojmë kërkesëpadinë dhe njoftojmë palën paditëse se këtu kemi të bëjmë me konflikt administrativ i cili është hapur pranë kësaj gjykate, arsyeja e hapjes së këtij konflikti është fshirja nga regjistrat kadastral të ngastrës kadastrale 1559-1 me sipërfaqe prej 13,400 m2, dhe se i tërë ky veprim ne si palë e interesit nuk kemi marr fare pjesë në procedurë për kundër faktit që është atakuar një e drejtë themelore siç është e drejta pronësore. Gjykatës i propozojmë, shfuqizoi aktgjykimin Anr.234/21 dt. 20.10.2023, dhe ti kthehet e drejta pronësore ndërhyrësve si e drejtë ligjore dhe nga provat që sot pranuar është vërejtur se në regjistrat kadastrale me këtë aktgjykim është fshirë nga regjistrat kadastrale ngastra kadastrale e ndërhyrësve me numër 1559/1 e cila ngastër është regjistruara me punës të vlefshëm juridike me Aktgjykim të plotfuqishëm dhe se e paditura para se të bëj regjistrimin në regjistrat kadastral të ngastrës së lartshënuar e ka bërë verifikimin e Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe pas verifikimit të këtij aktgjykimi është bërë edhe regjistrimi në emër të ndërhyrësve. Gjatë zhvillimit të konflikti administrativ vlen të përmendet se AKK përkundër faktit që ka pranuar ti regjistrohet pronësia ndërhyrësve pas nxjerrjes së Aktgjykimit të shkallës së parë nuk ka bërë fare ankesë. Po i kthemi provave me të cilat paditësja pretendon të kontestoi Aktgjykimin e plotfuqishëm. Arsyeja pse është iniciuar procedura gjyqësore pas luftës ka qenë se ndërhyrësit gjatë kohës së luftës e kanë humbur Aktgjykimin dhe kanë filluar me procedura tjera gjyqësore. Në momentin kur është gjetur aktgjykimi edhe është tërhequr aktgjykimi i plotfuqishëm është bërë tërheqja e padisë. Sa i përket provave të cilat paditësja i llogarit si res judikata, shkojmë tek aktvendimi i 2007 i Gjykatës Komuna e në Prishtinë, ku kjo gjykatë me vendimin 2365/2, me këtë vendim e zgjidh çështjen se palët nuk kanë legjitimitet dhe si rezultat i këtij vendimi dhe legjitimitetit të palës në atë kohë, ndërhyrësi i drejtohet Dhomës së Posaçme dhe kjo e fundit nxjerr vendim të njëjta ku thotë se Dhoma e Posaçme nuk ka kompetencë ta shqyrtoi, ashtu vendos edhe shkalla e dytë e Dhomës së Posaçme ku e detyrojnë palët të filloi procedurë të rregullt në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në momentin kur pala e gjen aktgjykimin e plotfuqishëm e bënë kërkesën për tërheqjen padisë, pra arsyeja e tërheqjes është se ekziston Aktgjykimi i Plotfuqishëm”.*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër 04-1757-04 dt.16.02.1953, vendimi me numër 6146 i dt.24.11.1954, aktgjykimi me numër 1150/96 i dt.16.08.1996, vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër P.nr.1506/06 dt.24.09.2007, padia e dt.06.10.2007, përgjigje në padi dt.04.12.2009, vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër 1292/2010, dt.22.06.2010, Urdhëri i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër SCC-10-0404 i dt.08.03.2011, Përgjigje ndaj urdhërit dt. 27.03.2011, Aktvendimi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër ASC-11-0046 data nuk shihet, Aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër SCC-10-0404 i dt.11.06.2012, Padia për vërtetimin e pronësisë dt.21.08.2012, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nën shenjen C.nr.2267/12 dt.03.06.2020 dhe Aktvendimi për përmirësim të këtij Aktvendimi i dt.04.06.2020, certifikata P-71914059-01559-1 dt.15.04.2019, aktvendimi i të paditurës me numër 03/1221/19 i dt.03.07.2020, kërkesa për procedim të lëndës e Komunës së Prishtinës e dt.27.07.2020, Përgjigje e dt. 03.08.2020, kërkesa për sqarim e dt.30.09.2020, kërkesa për sqarim e dt.10.11.2020, përgjigje në kërkesë dt.08.10.2020, 16.10.2020, 26.11.2020 dhe 06.08.2020, shikohet kopja e planit me numër të njësisë 71914059-01559-1 e dt.27.03.2017, njoftimi i dt.21.01.2021, aktvendimi i të paditurës me numër reference 03/1638 /20 i dt.11.12.2020, Aktvendimi i Komunës së Prishtinës me numër referent të lëndës 011-463-2/728/19/21 i dt.19.01.2021, Certifikata me numër P-71914059-01559-1 dt.15.11.2010, vendimi me numër 03/1221/19 dt.03.07.2020, kërkesa për rishqyrtim të rastit dt. 10.06.2019, konkluzioni i Komunës së Prishtinës dt. 15.04.2019, vendimi i K.K. Prishtinë nr.010 nr.435/03 -46766/19 dt.28.02.2019, përgjigje nga Gjykata Themelore me numër 11-030/04-0073791/19 dt.29.03.2019, kërkesa për përkthim e dt. 04.04.2019, dëftesa e dt. 04.03.2019, kërkesa e dt. 15.04.2019, kërkesa për ndërprerje të shqyrtimit të lëndës e Institutit Bujqësor në Pejë dt. 30.04.2019, Aktvendimi i dt. 01.07.2019, njoftimi i dt.18.07.2019, kërkesa për ekzekutim të Aktgjykimit e dt.15.07.2019, përgjigje në kërkesë dt.09.08.2019, njoftimi dt.30.09.2019, përgjigje e dt. 04.08.2020 dhe 02.03.2020, kërkesa e dt. 03.06.2020, shkresa nga Afrim Islami drejtuar AKK-së, e dt.13.02.2020, kërkesa e dt. 19.08.2020, Aktvendimi i Komunës së Prishtinës i dt.10.08.2020, kërkesa për plotësim të lëndës dt. 03.09.2020, certifikata me numër P-71914059-01559-1 data nuk shihet qartë, thirrja nga Policia e Kosovës e dt.27.11.2020, njoftimi i dt.14.12.2020. Udhëzimin Administrativ nr.2003/3 për rolin dhe mandatin e Institutit Bujqësor të Kosovës dhe certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-01559-1 të dt.06.03.2024 si dhe tërheqja e padisë e dt. 19.11.2019.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditëses lidhur me kërkesëpadinë e saj dhe gjeti se padia është e bazuar, ndërkaq pretendimet e palës së interesit u hodhën poshtë si të palejuara.

Gjykata rivlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse, duke vepruar kështu në përputhje të plotë me kërkesën e palës së interesit për rishikim të procedurës, ashtu që me Aktvendimin e datës 06.03.2024 kishte aprovuar propozimin për rishikimin e aktgjykimit duke ja njohur cilësinë e palës së interesit dhe duke caktuar seancën e shqyrtimit kryesor e duke e ftuar dhe përfshirë edhe palën e interesit J.. D.. në cilësinë e palës së interesit.

Gjykata gjeti se vendimi i të paditurës është i përfshirë në shkelje të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative për shkak se i njëjti nuk ka trajtuar në mënyrë të qartë të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe bazën ligjore mbi të cilën janë ndërtuar pretendimet e paditësit për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, e paditura nuk ka zbatuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë nenin 48 të LPPA-së në të cilin thuhet:

*“Neni 48-Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim*

*1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:*

*1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;*

*1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;*

*1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;*

*1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;*

*1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;*

*1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.*

*2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

Gjykata vlerësoi se organi i paditur, në pjesën e arsytimit nuk ka trajtuar qartë pretendimet konkrete të paditëses e të cilat i referohen kundërligjshmërisë së vendimit të atakuar me padi.

Organi i paditur, gjatë riprocedimit, e konform nenit 132 të LPPA-së, duhet të ketë parasysh të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga pala dhe të marr parasysh veçanërisht, dokumentet ligjore përkatësisht vendimet e Gjykatave dhe Institucioneve.

Organi i shkallës së dytë duhet të analizoj me kujdes të gjitha provat materiale të cilat i posedon, ndërkaq të kërkoj nga paditësja dokumentacione shtesë nëse kjo do të shihet si e nevojshme dhe e domosdoshme që të vendoset në mënyrë të drejtë dhe duke mos anashkaluar të drejtat themelore të paditëses të garantuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Organi i paditur detyrohet që të vlerësoj në mënyrë të saktë dhe të drejtë pretendimin e paditëses se çështja gjyqësore, mbi rezultatin e së cilës kishte vendosur e paditura, paraqet çështje e gjykuar apo *res judicata*. Në këtë kuptim, organi i paditur obligohet që t'i përgjigjet këtyre pretendimet duke vlerësuar të njëjtat dhe duke dhënë sqarimet e nevojshme nëse i pranon apo jo këto pretendime dhe të njëjtat ti arsyetoj.

Organi i paditur obligohet që të trajtoj pretendimet e paditëses në lidhje me atë se kjo çështje juridike ishte gjykuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë me aktvendimin ASC-11-0046 si dhe hedhjen e padisë së D.. J., M.. D.. dhe S.. S.. nga po e njëjta Dhomë e Gjykatës Supreme. Organi i paditur obligohet të marr në shqyrtim dhe të vlerësoj lidhmërinë në mes të Aktgjykimit C.nr.1150/96 të datës 15.09.1995 si dhe vendimeve të nxjerra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës si dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe kështu të garantoj barazinë e plotë të armëve në procedurë administrative, përkatësisht të mundësoj vlerësimin adekuat të të gjitha provave materiale të paraqitura edhe nga pala paditëse.

Organi i paditur poashtu obligohet të vlerësoj pretendimet e palës paditëse se në lidhje me këtë çështje juridike, Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin C.nr.2267/12 të datës 03.06.2020 e kishte konsideruar të tërhequr padinë e paditësve së D.. J.., M.. D.. dhe S..S...

Organi i paditur detyrohet të jap përgjigje të qartë mbi pretendimin e paditëses se akti i kontestuar i marrë nga e paditura është i kundërligjshëm për shkak se i njëjti është në kundërshtim me neni 361 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili i referohet situatës kur kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, parashkruhen për 10 vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim. Trajtimi i këtij pretendimi të paditëses nga ana e të paditurës në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes në këtë çështje juridike, është thelbësor në sqarimin e gjithëmbarshtëm të situatës juridike. Kështu, organi i paditur detyrohet që në aktin e ri të nxjerrë pas procedurës së rishqyrtimit të vlerësoj çështjen e parashkrimit duke argumentuar me prova, fakte dhe bazueshmëri të saktë ligjore vendimin e vet.

Organi i paditur poashtu detyrohet të trajtoj dhe vlerësoj pretendimet e paditëses mbi kërkesat që dalin nga Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve GZ RSFJ Nr.30/1978, përkatësisht nenin 379 të këtij Ligji, pastaj nenin 1, paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013 për Zbatimin e Ligjit për Kadastër, nenin 9, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/2019 si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

Organi i paditur detyrohet që të trajtoj me kujdes poashtu edhe pretendimet e paditëses sa i përket kundërligjshmërisë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1150/96 të datës 15.09.1995, duke vlerësuar jo vetëm dokumentin në aspektin formal, por duke analizuar me kujdes të veçantë pretendimet e palës paditëse për datat e mbajtjes së seancës, datën e padisë së ushtruar dhe kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit përkatës e poashtu edhe bazën ligjore në të cilin bazohet ky Aktgjykim.

Organi i paditur detyrohet të vlerësoj përputhshmërinë e të dhënave të regjistruar në kadastër me të dhënat e ofruara nga ky Aktgjykim, përkatësisht të vlerësoj nëse ekziston mospërputhshmëria e të dhënave ashtu siç pretendon paditësja. Sqarimet në lidhje me këtë, e paditura duhet ti jap në mënyrë të saktë dhe konkrete.

Organi i paditur nuk do të kufizohet vetëm në faktin e vetëm të ekzistimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1150/96 të datës 15.09.1995, por do të vlerësoj me kujdes të gjitha pretendimet e palës paditëse me të cilat pohon se i njëjti është i kundërligjshëm për të gjitha arsyet e dhëna më lartë.

Organi i paditur duhet të trajtoj qartë dhe në mënyrën e duhur të gjitha provat materiale, angazhohet dhe shqyrtoj të gjithë legjislacionin pozitiv në fuqi që aplikohet në rastet konkrete dhe në bazë të vlerësimit ligjor të marr vendim të drejtë. Është detyrë dhe përgjegjësi e organit të paditur që vet të hulumtoj kornizën ligjore dhe aplikueshmërinë e ligjit në rastin konkret.

Organi i paditur obligohet që të zbatoj nenin 95 të LPPA-së, duke i dhënë mundësinë ligjore të garantuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht duke e dëgjuar palën paditëse dhe duke kërkuar sqarime e dokumente shtesë të cilat do të ishin të rëndësishme në marrjen e një vendimi merititor.

Organi i paditur, gjatë gjithë rrjedhës së procedurës administrative të kthyer në rishqyrtim, duhet të demonstroj në veprime, por edhe të reflektoj në përmbajtjen e aktit të ri që do ta nxjerr, se e njëjta siguron zbatimin e Nenit 6-Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, Nenit 7-Parimi i objektivitetit dhe paanësisë, si dhe Nenit 8-Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme.

Organi i paditur duhet të kujdeset që gjatë gjithë rrjedhës së procedurës, të veprojnë në përputhje të plotë me nenin 132 të LPPA-së. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditësve, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditësve.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojnë të metat e cekura, të marrin vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e palës së Interesit J.. si kërkesë të palejuar, për faktin që gjykata ka tagër ekskluziv që të vlerësojë ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative të nxjerra nga ana e organeve shtetërore apo të urdhëroj nxjerrjen e aktit administrativ i cili nuk është nxjerrë nga organet shtetërore. Në këtë drejtim, kërkesa për kthimin e të drejtës pronësore është kërkesë e natyrës civile dhe jo e konfliktit administrativ.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.234/2021, datë: 08.04.2024

Gj y q t a r i

---



Numri i lëndës: 2021:019128  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05558790

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.